



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data** 26 gusht 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Thaçit për Zgjatje të Afatit**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**

Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Viktimave**

Sajmon Loz

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**

Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullat 9 dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 23 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi që Hashim Thaçit (“z. Thaçi”) t’i vazhdohet paraburgimi (“Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin”).<sup>2</sup> Në atë vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu urdhëroi z. Thaçi që të paraqesë, nëse dëshiron, parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit, ose deri të mërkurën, 31 gusht 2021, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores, ose deri të premtën, 16 shtator 2021, në përgjigje të parashtrimeve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) që do të dorëzohen të hënën, 6 shtator 2021.<sup>3</sup>

2. Më 16 gusht 2021, z. Thaçi parashtrroi apelin kundër Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin.<sup>4</sup>

3. Më 25 gusht 2021, z. Thaçi paraqiti kërkesë për zgjatjen e afatit për dorëzimin e parashtrimeve lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit, sipas rastit, deri në dhjetë ditë nga marrja e vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelin e pritshëm

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00417, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 23 korrik 2021, konfidencial, para. 64(a). Versioni i redaktuar publik u dorëzua për protokollim të njëjtën ditë, F00417/RED.

<sup>3</sup> Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 64(b) dhe (c).

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, IA010/F00004, Mbrojtja për z. Thaçi, *Apelim i Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 16 gusht 2021, konfidencial.

("Kërkesa").<sup>5</sup> Ai parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e kërkuar të afatit, sepse parashtrimet e ardhshme në lidhje me rishikimin e paraburgimit, sipas rastit do të jenë më kuptimplota nëse bëhen pas marrjes dhe shqyrtimit të vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit, veçanërisht duke marrë parasysh se Paneli i Gjykatës së Apelit do të shqyrtojë për herë të parë çështjet lidhur me lirim të përkohshëm në një Shtet të Tretë.<sup>6</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të shkurtojë, *proprio motu*, çdo afat të përcaktuar prej Rregullores ose prej Panelit.

5. Në pajtim me rregullën 9(6) të Rregullores, në qoftë se nuk i shkaktohet dëm palës kundërshtare, vendimi mbi një kërkesë për ndryshimin e afatit mund të merret pa i dhënë palës kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin.

6. Neni 41(10) i Ligjit dhe rregulla 57(2) e Rregullores përcakton se, me kalimin e dy (2) muajve nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Paneli i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendimin për vazhdimin ose përfundimin e paraburgimit.

## III. DISKUTIM

7. Pasi ka shqyrtuar arsyet e paraqitura nga z. Thaçi, veçanërisht faktin se do të ishte më mirë që parashtrimet e tij lidhur me paraburgimin të bëhen pas shqyrtimit të vendimit të pritshëm të Panelit të Gjykatës së Apelit, Gjykatësi i Procedurës

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, F00441, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Zgjatjen e Afatit për Parashtrime lidhur me Rishikimin e Paraburgimit*, 25 gusht 2021, publike.

<sup>6</sup> Kërkesa, para. 4.

Paraprake konstaton se janë paraqitur arsye të vlefshme që përligjin zgjatjen e kërkuar të afatit. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se z. Thaçi ka hequr dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit para përfundimit të afatit dymujor të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores.<sup>7</sup>

#### IV. VENDIM

8. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **MIRATON** Kërkesën dhe **URDHËRON** z. Thaçi të dorëzojë parashtrime nëse ekzistojnë ende arsye për vazhdimin e paraburgimit, jo më vonë se **dhjetë ditë pas njoftimit të vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit** mbi apelin e pritshëm të tij kundër Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe
- (b) **URDHËRON** ZPS-në që, në rast se z. Thaçi vendos të mos paraqesë parashtrime brenda afatit të lartpërmendur, të dorëzojë parashtrimet e veta lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Thaçi jo më vonë se **dhjetë ditë pas afatit të z. Thaçi**, dhe zotin Thaçi që të paraqesë parashtrimet e veta, nëse dëshiron, jo më vonë se dhjetë ditë pas afatit të ZPS-së.

\_\_\_\_\_  
/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

<sup>7</sup> Kërkesa, para. 6.

E enjte, 26 gusht 2021  
Në Hagë, Holandë.